

RAPORT PROGRESI (2010)

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT (DPS)

1. Hyrje

Objektiv i punës së DPS ka qenë zbatimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) i cili reflekton detyrimet e DPS ndaj nenit 75 të Marrëveshjes.

2. Legislationi

DPS funksionon bazuar në ligjin nr. 9870, datë 04.02.2008 “Për standardizimin”. Mbështetur në këtë ligj, në Korrik 2009 është miratuar VKM “Mbi zbatimin e Marrëveshjes së OBT/TBT dhe OBT/SPS”, ku detyrimet për SPS nën OBT i kaluan Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Në Maj 2010 u miratua VKM nr. 433, “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS”. Gjatë vitit 2010, është ndjekur me përparësi procedura e miratimit të Projektligjit për disa ndryshime në ligjin ekzistues “Për Standardizimin”, prej ku DPS do të marrë në kompetencë adoptimin dhe publikimin e standardeve të fushës së telekomunikacionit. Për momentin projektligji ka kaluar fazat e marrjes dhe reflektimit të komenteve nga ministrinë e linjës dhe pritet të kalojë për në mbledhjen e radhës të Qeverisë. Brenda 6 mujorit të parë të 2011 pritet miratimi nga Parlamenti i projektligjit në fjalë.

3. Bordi Drejtues

Pas shqyrtimit të kandidaturave të propozuara, u miratua përbërja e Bordit Drejtues dhe Rregullorja e Brendshme për funksionimin e këtij Bordi. Ndërkohë në mbledhjen e tij të parë në fillim të muajit Dhjetor, Bordi Drejtues ka kryer konstituimin e tij dhe ka marrë disa vendime si:


- Miratimi i Bordit Teknik
- Miratimi i Rregullores së funksionimit të Bordit Teknik
- Miratimi i Planit të Punës së DPS për vitin 2011.

Ngritja dhe funksionimi i Bordit Drejtues ka qenë një nga rekomandimet e BE-së për standardizimin në Shqipëri.

4. Adoptimi i standardeve Europiane


Deri në fund të vitit 2010 DPS ka realizuar planin e saj për adoptimin e mbi 95% të totalit të standardeve EN të të dy organizmave evropiane të standardizimit, CEN dhe CENELEC. Gjatë vitit 2010 janë miratuar 1857 standarde, 426 amendamente dhe 198 dokumenta standardizimi, nga të cilat 1657 janë standarde evropiane (1283 janë standarde të CEN dhe 374 janë standarde të CENELEC) dhe 200 janë standarde ndërkombëtare (81 janë standarde të ISO dhe 119 janë standarde të IEC). Gjithashtu gjate këtij viti është miratuar dhe një standard puro shqiptar nga KT 19 “Produkte naftë, lubrifikante dhe produkte që lidhen me to”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet gjendjen aktuale të Standardeve Shqiptare dhe strukturën sipas llojeve:




| Lloji | S SH | S SH EN | S SH ISO+IEC | Others | Totali |
|-----------|------|---------|--------------|--------|--------|
| Standarde | 3176 | 16639 | 2185 | 748 | 22748 |

Struktura e standardeve S SH vazhdon të ketë një përmirësim të dukshëm, në favor të EN-ve të adoptuara, siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm:




| Viti | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 |
|-----------|------|------|------|------|------|------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Puro S SH | 3557 | 3558 | 3558 | 3563 | 3565 | 3520 | 3487 | 3359 | 3332 | 3283 | 3176 |
| Adoptime | 1281 | 2408 | 3479 | 5002 | 6525 | 9070 | 11860 | 14952 | 17443 | 18568 | 19572 |

Progresi i standardeve S SH të publikuara çdo vit tregohet si më poshtë:



| Viti | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 |
|---------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| St.reja | 143 | 872 | 1128 | 1072 | 1527 | 1516 | 2499 | 2800 | 3700 | 4066 | 2353 | 1857 |

Janë adoptuar 100% e standardeve Evropiane të harmonizuara si Standarde Shqiptare të harmonizuara. Deri tani janë në fuqi 16 639 standarde evropiane ndër të cilat 4.559 janë standarde të CENELEC. Numri i standardeve EN të adoptuara si S SH në fushën e elektroteknikës (CENELEC) është si më poshtë:



Ecuria në vite e standardeve në fuqi paraqitet në tabelën si vijon:

| Viti | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 |
|---------------------|------|------|------|------|------|------|------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Standarde Evropiane | 82 | 985 | 1590 | 2425 | 3907 | 5357 | 7860 | 10000 | 12877 | 14993 | 15805 | 16639 |
| Standarde CENELEC | | | | | | 90 | 740 | 1640 | 2537 | 3958 | 4370 | 4559 |

Adoptimi i standardeve është bërë me metodën me faqe të parë. Numri i standardeve të përkthyera në shqip është shumë i vogël krahasuar me totalin e adoptimeve.

Gjatë vitit 2010 janë shfuqizuar gjithsej 915 standarde, nga të cilat 800 janë S SH EN (615 janë standarde të CEN dhe 185 janë standarde të CENELEC), 25 standarde S SH ISO, 5 standarde Gjermane S SH DIN, 85 S SH puro shqiptare, 33 amendamente, dhe 10 dokumenta standardizimi, të shfuqizuara nga organizmat përkatëse.

5. Plotësimi i 9 kushteve për anëtarësim në CEN/CENELEC

DPS është duke punuar për përshtatjen e procedurave të saj të punës me procedurat e CEN/CENELEC, të cilat pritet të miratohen në mbledhjet e ardhshme të Bordit Drejtues.

-Në Maj 2010, me asistencën e projektit CARDS 2006 u bë e mundur vizita vlerësuese mbi ecurinë e plotësimit të 9 kushteve për t'u bërë antarë me të drejta të plota në CEN & CENELEC. Një plan pune i detajuar është lënë për zbatim nga eksperti i fushës.

-Me asistencën e projektit BERIS kanë përfunduar ndërhyrjet në lidhje me përmiresimin e bazës së të dhënave të DPS dhe infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit. Kjo bazë të dhënash bashkë me infrastrukturën do të thjeshtojë shumë aksesin për marrjen e informacioneve mbi standardizimin në Shqipëri, duke i ardhur në ndihmë biznesit vendas dhe atij të huaj. Aktualisht projekti është në fazën e trajnimeve dhe testimit të infrastrukturës së ofruar dhe parashikohet të përfundojë në Janar, 2011.

-DPS ka marrë pjesë si vëzhgues në punën europiane të standardeve në KT CEN/TC 19 – “Gaseous and liquid fuels, lubricants and related products of petroleum, synthetic and biological origin” (Produkte naftë, lubrifikante, qymyre dhe produkte që lidhen me të).

-Tregues tjetër i punës sonë do të jetë edhe identifikimi dhe shfuqizimi i standardeve të cilat konfliktojnë ose jo standardet evropiane në fuqi.


6 Promovimi

Faqja e internetit www.dps.gov.al ku jepet informacion rreth DPS-s dhe mënyrës së organizimit të sistemit të standardizimit në Shqipëri është pasuruar dhe rifreskuar me informacione të reja si njoftime, artikuj, aktivitete etj. Ngjarjet më të rëndësishme të vitit për DPS janë pasqyruar në këtë faqe, duke përfshirë takimet e kryera me bizneset në disa qytete të vendit si Shkodër, Vlorë, Elbasan, takimet ndërkombëtare, takimet e zhvilluara në DPS, paketa të reja standardesh, buletine informative, katalogun e standardeve etj. Gjatë këtij viti, me asistencën e projektit CARDS 2006, u zhvillua një simpozium mbi implementimin e direktivës së ndërtimit dhe roli i standardeve të harmonizuara nën këtë direktivë, për të cilën u publikua edhe një guidë. Gjatë vitit 2010 numërohen rreth 9.500 klikime në faqen kryesore dhe 20,377 vizita për nën faqet e DPS. Janë botuar e shpërndarë në vijimësi një numër broshurash dhe fletëpalosjesh për DPS, për Afrimin e Ri dhe standardet që lidhen me to, standardet e cilësisë së ujit, mbrojtjen e konsumatorit, çertifikimet etj, njoftime për shtyp dhe artikuj për Ditën Botërore të Standardeve, 14 Tetor 2010. Buletinët informative dhe Katalogu i Standardeve Shqiptare janë përgatitur në *hard copy* dhe elektronikisht në CD dhe gjenden në faqen tonë të internetit në linkun <http://www.dps.gov.al/dpsonline/search.php?gj=Al>.

7. Shitja e standardeve

Shitja e standardeve është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar dhe Guidat 10 dhe 12 të CEN & CENELEC. Gjatë vitit 2010 janë shitur gjithsej **2055** standarde Shqiptare (S SH) (përkundrejt **1611** standardeve S SH në 2009) ose e shprehur në përqindje **28%** më shumë, nga të cilat për këtë vit 1885 standarde janë standarde Evropiane (S SH EN), përkundrejt 1306 gjatë 2009 ose **45%** më shumë.

Totali i standardeve të shitura gjatë 2010 dhe standardet me origjinë europiane (S SH EN) krahasuar me 2009 jepen si vijon:



8. Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika e Referimit në OBT

Edhe gjatë këtij viti DPS ka kryer notifikimet e programeve të punës 6 mujore të standardeve në Qendrën e Përbashkët të Informacionit të ISO/IEC ka notifikuar në CEN & CENELEC të gjitha Standardet e adoptuara si Standarde Shqiptare si dhe mënyrën e tyre të adoptimit (me devijime apo jo). Lidhur me detyrimet që DPS ka si Pikë Referimi e OBT, gjatë këtij viti janë qarkulluar rregullisht të gjitha notifikimet e marra nga vendet anëtare të OBT, në të gjithë ministritë dhe institucionet shtetërore, sipas përkatësisë. Po gjatë këtij viti janë bërë 2 notifikime shqiptare (TBT) të projekt ligjeve të ardhura nga ministritë e linjës dhe janë dërguar tekstet ligjore të këtyre notifikimeve të kërkuara nga shtetet anëtare. Gjithsej, që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së OBT janë bërë 43 notifikime të projekt akteve ligjore e nënligjore me ndikim në tregti (TBT).

9. Sistemi i menaxhimit të cilësisë

DPS mbetet i vetmi institucion publik i çertifikuar sipas standardit ISO 9001 dhe sistemi i saj i menaxhimit të cilësisë është në përmirësim të vazhdueshëm, veçanërisht për implementimin e standardit ISO 9001:2008 dhe zëvendësimin e versionit të vitit 2000. Gjithë dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të cilësisë është rishikuar dhe në Qershor 2010 ky sistem, gjatë çertifikimit mbi aplikimin dhe zbatimin e standardit S SH EN ISO 9001:2008, u vlerësua pozitivisht nga trupa e auditimit CSQ (anëtare e rrjetit ndërkombëtar IQNET).

10. Objektivat për 2011

- Miratimi i projektligjit për disa ndryshime në ligjin për standardizimin - standardet ETSI;
- Miratimi i projekt Vendimit të Këshillit të Ministrave për zbatimin e Kodit të Praktikës së Mirë për hartimin, adoptimin dhe miratimin e standardeve (Aneksi III i Marrëveshjes së OBT/TBT);
- Adoptimi i 97% të standardeve të CEN & CENELEC si Standarde Shqiptare (S SH)
- Progres i mëtejshëm në plotësimin e 9 kushteve;
- Rritje e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë vendas mbi rolin e DPS në tregun e lirë dhe mbi rëndësinë e përdorimit të standardeve Europiane në produktet dhe shërbimet e tyre;
- Rritje e shitjeve të standardeve S SH;
- Sigurimi në vijim i transparencës dhe informimit të publikut të gjerë nëpërmjet publikimeve të DPS (Buletinët, Katalogut të Standardeve Shqiptare dhe informimeve dhe njoftimeve të tjera të kësaj natyre); si dhe
- Sigurimi i mëtejshëm i përfshirjes së të gjitha grupeve të interesuara në procesin e standardizimit.